




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilicuar: Më/Dani	15.03.2010
Nr. i organit	
Organi	
03-013/893 -	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 40.2, 82.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 22.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 02 nr 013/5165 të datës 18.11.2008, dhe kërkesës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për rishqyrtimin e Vendimit nr 01-013/4608 të datës 03.10.2008, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 05 mars 2010 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR 01-013/4608 TË DATËS 03.10.2008

Neni 1

Me këtë vendimi, Kuvendi i Komunës së Vitisë SHFUQIZON Vendimin numër 01-013/4608 i datës 03.10. 2008 për kthimin e të gjitha pronave të paluajtshme shoqërore titullarit të mëparshëm- Komunës së Vitisë.

Neni 2

Komuna e Vitisë, në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë dhe AKP (konform procedurave për shkëmbimin e tokës), do të kërkojë që pronat e shpallura me vendime të veçanta të Kuvendit të Komunës "prona me interes të përgjithshëm", pronat që gjenden brenda rrezes së Qytetit dhe ndonjë pronë tjetër që do të parashihet edhe me planin zhvillimor dhe planin urbanistik t'i mbeten Komunës.

Neni 3

Komuna e Vitisë mbetet e përkushtuar për mbrojtjen dhe zgjidhjen e problemeve të shumta të pronës në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet tjera qendrore.

Neni 4

Komuna e Vitisë kërkon nga institucionet qendrore dhe prania ndërkombëtare që ta shfrytëzojnë autoritetin dhe ndikimin e tyre për kthimin e dokumentacionit kadastral nga Serbia.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria për Kadastër, pronë dhe gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

01 Nr _____
Viti, 05 mars 2010

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYETARI

Skenderbe Hebibaj

